

Refugee-Guide:

Qe ta gjeni veten mirë në Hessen.





Bashkëpunëtore dhe bashkëpunëtorë të dashur si dhe udhëheqës të institucioneve për pranimit të parë dhe strehim, por para së gjithash:

Refugjatë të dashur,

Ju kërkoni mbrojtje në Gjermani dhe Hessen dhe pas ikjes së gjatë Ju duhet të orientoheni të rraskapitur në një vend të huaj. Kjo është një situatë shumë e vështirë. Mua më vjen mirë, Juve të ju ofroj ndihmë me këtë broshurë, për të cilën ne duhet të i falënderohemi shumë ndihmësve vullnetarë, doktorantëve dhe studentëve. Ata këtë Refugee-Guide jo vetëm që e kanë përpiluar, shkruar dhe formuluar, porse ata na lejojnë të e përdorim pa pagesë dhe të ju japim Juve në dispozicion. Kjo punë meriton respekt dhe mirënjohje! Për këtë unë po them nga zemra: ju faleminderit! Para së gjithash koordinatorëve të projektit Michael Strautmann dhe Franziska Fischer.

Unë dëshiroj të ju përshëndes në emër të Qeverisë së Landit Hessen në Landin tonë federativ. Ne e dimë, që jeta në të ashtuquajturat strehimore për pranimit të parë nuk është gjithmonë e thjeshtë. Mirëpo duke marrë parasysh vendet e shumta të krizave në botë si dhe numrin e njerëzve, të cilët kërkojnë strehim tek ne, fatkeqësisht në fillim të qëndrimit këtu nuk shkon ndryshe. Mirëpo ne në Hessen bëjmë gjithçka që të ju ndihmojmë! Për këtë Ju këtu duhet të jeni të sigurt.

Unë shpresoj, që Juve me Refugee-Guide të ju lehtësojmë pak hapat Tuaj të parë në një shtet tjetër me një kulturë dhe gjuhë tjetër.

I Juaji

Stefan Grüttner,

Ministri për çështje Sociale dhe Integrim i Hessen-it

Mirësevini në Gjermani!

Willkommen
in Deutschland!

Ky udhërrëfyes ka për qëllim që të ju ofrojë informata për vendin në të cilin gjendeni tani. Është përgatitur në përgjigje të pyetjeve të përgjithshme të refugjatëve. Pjesa më e madhe e këshillave në këtë libërth nuk duhet kuptuar si ligj ose rregulla strikte. Njerëzit në Gjermani jo çdoherë do të sillen sipas këtij udhërrëfyesi. Gjithsesi, shumica e sjelljeve të përshkuara më poshtë janë praktikë e zakonshme për shumicën e njerëzve, shumicën e kohës.

Përmbytje

Jeta publike	3
Liria personale	5
Jeta në bashkësi.	6
Barazia	7
Ambienti dhe ekologjia	8
Ushqimi, pijet dhe pirja e duhanit	9
Formalitete	11
Në raste emergjente	13
Lidhur me udhërrëfyesin	14

Jeta publike

'Guten tag' (Mirëdita) dhe 'Auf Wiedersehen' (Ditën e mirë) janë përshëndetjet e zakonshme. Zakonisht njerëzit përshëndesin të gjithë kur takohen me një ose disa persona. Për shembull, kur hyni në një shitore të vogël ose te mjeku me 'Mirëdita' ju përshëndesni të gjithë personat që janë aty. Njëjtë ju mund të përshëndesni njerëzit në fshat dhe zona të largëta.

Buzëqeshja në publik nuk konsiderohet flirtim edhe kur ju bisedoni me një të panjohur. Njerëzit mundohen të jenë të sjellshëm dhe

mikpritës kur buzëqeshin.

Njerëzit në Gjermani vlerësojnë hapësirën personale dhe privatsinë, që mund të tingëllojë sikur largësi dhe ftohtësi ndonjëherë. Është krejt e zakonshme që të uleni afër një të panjohuri në tren ose restoran për orë të tëra dhe të thoni vetëm përshëndetje dhe ditën e mirë. Gjithashtu, shumë njerëz pëlqejnë të ulen vetëm në transportin publik.



Për shkak të privatsisë dhe qetësisë, njerëzit shpesh i mbyllin dyert, p.sh. në ndërtesa të mëdha zyresh apo shtëpi. Është mirësjellje që të trokisni në derë para se të hyni dhe zakonisht ju do të ftoheni brenda dhe pyeteni.

E diela është ditë e qetë. Gati të gjitha shitoret janë mbyllur dhe shumë pak njerëz punojnë. Fqinjët mund të ankohen nëse zëri juaj ju pengon, p.sh. nëse prisni barin ose montoni rafte në mur. Po ashtu, njerëzit në Gjermani duan qetësi gjatë orëve të gjumit nga ora 10 në mërmje deri në 7 në mëngjes.

Urinimi në publik mund të jetë ofendim. Toaletet publike gjenden në shumë vende. Ato zakonisht janë të pajisura me letër toaleti, por jo edhe me mini çezme. Është krejt në rregull të hidhni letrën e toaletit në guaskë (shole), e jo në shportën e bërllokut. Kjo nuk vlen për tamponët dhe fashat sanitare. Përdorni brushën për të pastruar guaskën. Sigurohu që toaleti të jetë i pastër dhe i tharë kur të largoheni. Prandaj, rekomandohet që të përdorni guaskën duke u ulur në të. Në rast se nuk ka urinal ne objekt, kjo vlenë edhe për meshkujt. Larja e duarve para se të largoheni është pjesë e standardit higjienik.

Bisedat e gjata dhe te zëshme në publik, veçanërisht në transportin publik, konsiderohen të pahijshme. Bisedat dhe telefonatat bëhen me zë të ulët.

Në transportin publik gjenden ulëse dhe vende të rezervuara për të moshuar, të sëmurë, shtatëzëna dhe disa për karroce. Njerëzit zakonisht i lënë këto vende të lira ose largohen kur dikush ka nevojë t'i përdor.

Në shkallët lëvizëse, njerëzit zakonisht

qëndrojnë në anën e djathtë dhe ecin në anën e majtë.

Nëse keni nevojë për ndihmë, lirisht pyesni cilindo person të rritur. Zakonisht njerëzit janë të sjellshëm. Rekomandohet që të mos u afroheni fëmijëve pa lejen e prindërve të tyre.

Liria personale

Secili person mund të praktikoj fenë e tij/ saj ose asnjë fe. Feja konsiderohet çështje private. Pra, ju jeni i lirë të besoni në çfarëdo feje, por po ashtu ju duhet të pranoi faktin se njerëz të tjerë besojnë në Zot tjetër, apo nuk besojnë fare.

Disa sauna dhe pishina lejojnë praninë 'pa rroba'. Përndryshe, njerëzit veshin rrobabanjo në pishina publike. Zakonisht saunat dhe pishinat nuk ndahen sipas gjinisë, edhe pse ndonjëherë femrat dhe meshkujt kanë orare të veçanta.

Opinionet dhe debatet në Gjermani orientohen nga kompromisi dhe jo grindja. Shtypi ka një liri të veçantë, lirinë e shtypit. Kjo garantohet me ligj. Shtypi adreson një gamë të gjerë të çështjeve, përfshirë edhe kritikën ndaj qeverisë dhe institucioneve (përfshi kishën). 'Liria e shprehjes' ju mundëson juve të thoni atë që mendoni, përderisa nuk është diskriminuese, fyese apo kërcënuese.



Shprehja e ndjenjave në publik nga çiftet (e gjinisë së njëjtë ose të kundërt) është e zakonshme. Kjo mund të përfshijë mbajtjen e duarve, puthjen dhe ledhatimin në vende publike. Kjo është e sjellje e pranueshme dhe duhet injoruar kur të kaloni pranë.

Zhveshja e pjesshme është e zakonshme dhe normale, psh veshja e bluzave me mëngë të shkurta, pantallona të shkurtë apo mini funde. Ngulitja e syve te të tjerët konsiderohet e pasjellshme.

Jeta në bashkësi.

Njerëzit në Gjermani përdorin shtërngimin e duarve shpesh, dhe atë kur të takohen dhe largohen, dhe kur të takojnë njerëz të ri. Konsiderohet e zakonshme që kur një person bashkohet me një grup të shtërngoj duart me gjithësecilin. Kjo shoqërohet me shikim drejt në sy të personit që i jipet dora. Shtërngimi i durave me të gjithë, meshkuj dhe femra, është i zakonshëm.



Kur shokët takohen, është e zakonshme që të përqafohen, dhe në disa rajone të Gjermanisë, të puthin të tjerët, zakonisht personat e gjinisë tjetër, në faqe. Kjo kuptohet në një mënyrë shoqërore joseksuale.

Shpesh njerëzit thonë atë që mendojnë. Ata nuk duan të jenë të pasjellshëm por të sinqertë. Kriticizmi (konstruktiv) konsiderohet pjesë thelbësore e përmirësimit të vetvetes dhe të tjerëve, veçanërisht në punë.

Saktësia është me rëndësi. Nëse vonoheni në takim, qoftë edhe 5 minuta, mund të konsiderohet mungesë respekti sepse ju lini personin tjetër të presë. Nëse jeni vonë, thërrisni personin tjetër dhe njoftojeni për vonesën. Kjo është e zakonshme si në punë si në jetën private, kur takoheni me miq.

Nëse ju ofrojnë dicka, 'nein, danke' (jo, falënderit) është 'jo' e sjellshme, dhe 'bitte' or 'gerne' nënkupton 'po'.


Barazia

Diskriminimi gjinor, racor, fetar apo seksual është ilegal dhe mund të dënohet. Nëse ju ndjeheni i diskriminuar ose kërcënuar, qoftë edhe verbalisht; lajmëroni policinë. Dhuna nuk është asnjëherë përgjigje ndaj çfarëdo komenti, qoftë ai fyes, diskriminues apo kërcënues. Për më shumë, dhuna është e ndaluar me ligj në Gjermani.

Femrat dhe meshkujt janë të barabartë dhe gëzojnë të drejta të njëjta. Nëse dikush (ai ose ajo) kërkon nga ju që ta lini të qetë, ju duhet ta bëni këtë. ngacimimi i të tjerëve, meshkujve dhe femrave, është i ndaluar. Kërkoni leje para se të fotografoni dikë.

Homoseksualizmi konsiderohet gjë normale në Gjermani. Për shembull, një ish ministër i jashtëm ishte publikisht homoseksual. Çiftet homoseksuale mund të bashketojnë ligjërisht.

Njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin kë dëshirojnë të martojnë apo nëse duan të martohen fare. Është krejt normale të mos martoheni, të keni prindër të pamartuar apo të mos keni apo dëshironi fëmijë.



Ambienti dhe ekologjia

Njerëzit në Gjermani njihen për sjelljen e tyre miqësore ndaj ambientit: ata ndajnë mbeturinat dhe mundohen t'i riciklojnë. Atyre nuk u pëlqen bërlloku në tokë. Kjo vlen për qytet po edhe për natyrë, psh parqe, afër rrugës apo në pyll. Zakonisht mbeturinat mblidhen dhe hidhen në shportën më të afërt, edhe kur kjo nënkupton që mbeturinat të barten me vete derisa të gjeni një shportë. Zakonisht shportat gjenden në vende publike, përfshirë stacionat e trenave, autobusëve, parqet etj.



Shumë njerëz në Gjermani mundohen të shpenzojnë sa më pak energji dhe burime. Kjo bëhet për të mbrojtur ambientin po edhe për të kursyer. Për shembull, njerëzit nuk e lënë frigoriferin hapur gjatë (në shtëpi ose market). Po ashtu, njerëzit ndalin dritat kur të largohen nga dhoma.

Zakonisht dritaret mbyllen hermetikisht. Prandaj, mund të jetë e nevojshme që për ajrosje të hapni dritaren kohë pas kohe. Për të kursyer energji, ndaleni ngrohjen kur dritarja është e hapur.

Shumë shishe mund të kthehen për një shumë prej 8-25 Centë. Ju mund t'i ktheni ato në secilin supermarket ku ato shiten, dhe jo vetëm në supermarketin ku i keni blerë. Kjo bëhet me qëllim që të ndihmohet ambienti duke ricikluar dhe përdorur për së dyti shishet dhe për të prodhuar sa më pak mbeturnina.

Ushqimi, pijet dhe pirja e duhanit

Uji i çezmes mund të pihet pa problem. Uji i çezmes në Gjermani mbikëqyret rreptësisht dhe s'ka asnjë rrezik. Ka disa përjashtime megjithatë, për shembull në vende publike apo trena, ku shkruhet qartë: 'Kein Trinkwasser' (uji nuk pihet).

Në Gjermani ju do të gjeni lloje të ndryshme të ushqimit si mish pule, viçi, derri. Nëse ju nuk hani ndonjë lloj mishi, ju mund



të pyesni lirisht për llojin e mishit në shujtë. Gjermanët zakonisht hanë shumë mish derri.

Ju mund të gjeni shumë vende që shërbejnë dyner, mish të pjekur dhe mbështjellur në petë buke. Zakonisht bëhet me mish viçi, pule ose qengji. Dyneri, sikurse ushqimet e tjera të shpejta (pica, hamburgeri, patatet e fërguara etj) zakonisht hahet pa

thikë dhe pirun. Thika dhe piruni përdoren kur të hani në tavolinë.

Shumë ëmbëlsira në Gjermani përmbajnë xhelatinë nga derri, pra nëse doni të siguroheni që ushqimi është hallall, bleni ato që shkruajnë 'vegetarian' ose shiko listën e përbërsve nëse ka 'Gelatine'.

Në Gjermani ka supermarkete të lira (psh ALDI, LIDL dhe Penny) dhe më të shtren-

jta (psh REWE dhe EDEKA) që ofrojnë çdo gjë që ju nevojitet. Po ashtu, ka edhe tregje të fermerëve dhe markete të vogla, përfshirë markete turke, afrikane, aziatike, greke etj. Nëse hani ushqime hallall, ju mund t'i gjeni ato zakonisht në markete (dhe restorane) turke ose arabe. Për dallim nga supermarketet, disa pompa te benzinës janë të hapura 24 orë dhe shpesh shesin ushqime, por janë më shtrenjtë.

Alkoholi, kryesisht birra dhe vera, konsiderohet pjesë e ngjarjeve shoqërore në mbrëmje, si gjatë darkës ose tubimeve. Mirëpo, është krejt e pranueshme të mos pini alkohol, sepse edhe shume gjermanë nuk e konsumojnë atë. Nëse ju ofrohet alkohol, ju mund ta refuzoni atë duke thënë 'nein, danke'. Vozitja pas konsumit të alkoholit është e ndaluar.

Pirja e duhanit bëhet në shumë vende publike, qoftë nga meshkujt, qoftë nga femrat. Në restorane dhe stacione të trenit ka zona speciale për pirje të duhanit 'smoking areas'. Zakonisht konsiderohet më e mirësjellshme të pihet duhan në ballkon ose jashtë. Pirja e duhanit afër atyre që nuk janë duhanpirës, fëmijëve ose grave shtatëzëna konsiderohet sjellje e keqe.

F

ormalitete



Dyqanet dhe zyret (zyrtare) hapen dhe mbyllen në kohë. Nëse për shembull orari i punës ('Öffnungszeiten') mbaron në ora 4 pasdite, rekomandohet që të jeni aty më së largu në ora 15:55 (3 e 55 pasdite), sepse në ora 16:01 (4 e 1 minut pasdite) dera do të jetë e mbyllur. E njëjta vlen edhe për orarin e trenave, autobusëve etj.

Të kesh punë me burokraci ndonjëherë është goxha punë e komplikuar dhe mund të duket joefikase. Procedurat marrin kohë sepse institucionet kanë rregullat e tyre. Kjo mund të ju frustrtoj. Gjithsesi, procedurat janë të njëjta për të gjithë dhe janë korrekte. Ofrimi ose marrja e rryshfetit është

krım.


Shumica e njerëzve në Gjermani respektojnë rregullat e komunikacionit. Ata respektojnë shenjat dhe ndalen në semafor edhe kur askush nuk është në anën tjetër. Nëse nuk ka shenjë ose semafor: personi që vjen nga e djathta ka përparësi ('rechts vor links').

Shirita të veçantë ekzistojnë për biçiklistë, veçanërisht në qytete. Përdorimi i telefonit gjatë vozitjes është i ndaluar. Të gjithë personat në veturë janë të obliguar të vendosin rripin e sigurisë. Fëmijët duhet të përdorin një ulëse të veçantë për madhësinë e tyre.

Thirrjet telefonike zakonisht bëhen gjatë orarit të punës. Pra, deri në ora 4 ose 5 pasdite. Thirrjet private nuk bëhen pas orës 9 ose 10 në mbrëmje. Kur të thërrasësh dikë në telefon prezantohuni me emër.

Kur të përdorni transportin publik, është e domosdoshme të blini biletën paraprakisht. Ju mund t'i blini ato në biletari ose aparat për bileta. Kur të hyni në tramvaj, autobus ose tren lokal, ndonjëherë ju duhet të validoni biletën për udhëtim (psh in Berlin ose Mynhen). Procedura dhe llojet e biletave dallojnë varësisht nga rajoni dhe qyteti.

Në raste emergjente



Mundohuni të ndihmoni personat që janë në rrezik. Mos qëndro anash, ju çdoherë mund të ndihmoni. Secili duhet që të ndihmojë personat në nevojë, psh duke u ofruar ndihmën e parë dhe lajmëruar shërbimin emergjent.

Në rast të konfliktit, vjedhjes, ngacmimit seksual: lajmëro policinë (thirr 110 në çfarëdo telefoni). Policët janë zakonisht të sjellshëm dhe janë aty për të ndihmuar dhe prandaj e marrin secilën thirrje seriozisht.

Në rast të zjarrit ose emergjencës mjekësore: lajmëro zjarrfikësit (thirr 112 në çfarëdo telefoni). Kjo linjë duhet përdorur vetëm për raste shumë serioze. E njëjta vlen për shërbimin e emergjencës në spital.

Për të takuar mjekun, refugjatët duhet fillimisht të konsultohen me zyrën e sigurimit shoqëror. Zyrat e mjekut zakonisht janë hapur nga ora 8 në mëngjes deri në ora 12 dhe ndonjëherë deri pasdite. Shumica e

mjekëve flasin anglisht.

Thirrjet telefonike zakonisht bëhen gjatë orarit të punës. Pra, deri në ora 4 ose 5 pasdite. Thirrjet private nuk bëhen pas orës 9 ose 10 në mbrëmje. Kur të thërrasësh dikë në telefon prezantohuni me emër.

Nëse keni nevojë për mjekun në mbrëmje, të dielave ose gjatë festave, ju mund të vizitoni një nga barnatoret kujdestare ('Not-Apotheke'). Përdorni google-in ose thirrni 22 8 33 (maksimum 69 Centë për minut) nga një telefon mobil për të kuptuar se cila barnatore punon gjatë kujdestarisë. Po ashtu, në dritaren e secilës barnatore ka udhëzime për barnatoren kujdestare më të afërt.

Lidhur me udhërrëfyesin

Ky udhërrëfyes është për vizitorë, refugjatë dhe shtetas të ardhshëm në Gjermani. Qëllimi është që të ju mundësoj orientim në fillimin e qëndrimit të tyre në Gjermani. Sa i përket refugjatëve, udhërrëfyesi ka për qëllim të ofrojë informata të nevojshme kur ata akoma nuk marrin pjesë në kurset e integritimit dhe të gjuhës gjermane që ofrohen nga qeveria. Që nga shtatori 2015, BAMF (Bundesamt für Migration und Flüchtlinge) nuk ofron informata të tilla.

Ky udhërrëfyes ofrohet në gjuhë të ndryshme dhe me ilustrime sipas nevojës. Mund të gjendet në internet dhe me mundësi të printimit dhe shpërndarjes. Libërthi i shtypur mund të dal më vonë.

Qëllimi i vetëm i këtij udhërrëfyesi është ofrimi i informacionit. Mirëpo, është e kuptueshme që ky udhërrëfyes mund të kuptohet si arrogant dhe fytes. Projekti vazhdimisht reflekton lidhur me këtë.

Koncepti dhe përmbajtja e këtij udhërrëfyesi është dizajnuar dhe hartuar me ndihmën e shumë njerëzve (nga Siria, Afganistani, Sudani, Egjipti, Palestina; njerëz që kanë emigruar së voni në Gjermani; njerëz që aktualisht janë refugjatë etj). Ishte shumë e rëndësishme për të përfshirë refugjatët në hartimin e këtij udhërrëfyesi. Gjatë diskutimit të prjektit me refugjatët, në veçanti është diskutuar lidhur

me atë nëse një udhërrëfyes i tillë mund të përceptohet si diçka arrogante dhe nënçmuese. Refugjatët në veçanti kanë ngritur këtë shqetësim dhe përkundrazi, ata kanë kërkuar informacion të tillë.



Impressum:
© Refugeeguide.de
Projektkoordination: Michael Strautmann, Franziska Fischer

Broschüren-Layout: Joanna Roer
Illustrationen: Maren Amini, maren-amini.de
Logo-Gestaltung: Freizeit-Werbeagentur.com

Redaktion: Viele ehrenamtliche Unterstützer, v.a. Studenten und Doktoranden, mit verschiedensten (geographischen und kulturellen) Hintergründen, die zu dieser crowd-gesourceten Orientierungshilfe beigetragen haben.

Übersetzungen:

Deutsch, Englisch, Arabisch, Französisch: eine Vielzahl ehrenamtlicher Unterstützer in Gemeinschaftsarbeit

Pashto: Organization of Afghan Alumni

Dari: Organization of Afghan Alumni und weitere Ehrenamtliche

Serbisch: Alexandra Vukovich

Mazedonisch: Alexandra Vukovich und Ana Ilievska Završnik

Albanisch: ein engagierter anonymer Unterstützer

Lektorat im Auftrag der Ernst Klett Sprachen GmbH:
Michael Krumm, mk-lektorat.de (Deutsch); Dr. Abbas Amin, arabisch-lektorat.de (Arabisch); Gillian Bathmaker (Englisch); Magali Armengaud (Französisch)

pesëmbëdhjetë

fünfzehn

HESSEN



Herausgeber:
**Hessisches Ministerium
für Soziales und Integration**

Dostojewskistraße 4
65187 Wiesbaden

www.soziales.hessen.de